



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**  
Mbledhja nr. 56  
Prishtinë, më 1.2.2017, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Murat Hoxha, Haxhi Shala, Salih Salihu dhe Time Kadrijaj.

Mungoi: Sergjan Popoviq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.1.2017;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për 2017 në fushën e bujqësisë, i ftuar ministri;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndonjë shtesë.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.1.2017**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 25.1.2017, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017 në fushën e bujqësisë, i ftuar ministri**

Kryetarja **Duda Balje**, lidhur me planin e punës së Komisionit për këtë vit në fushën e bujqësisë, falënderoi ministrin **Memli Krasniqi** për prezencën dhe e ftoi ta marrë fjalën. Ministri falënderoi Komisionin për ftesën duke konstatuar në fillim se dy vitet e kaluara kanë qenë joefikase në MB për shkak të mos hartimit të legjislacionit adekuat sidomos për ligjet me prioritet, siç janë për ushqimin dhe pyjet. Mirëpo kjo nuk është bërë për shkak të jo zotimeve financiare, ndaj është parë si e arsyeshme ma mirë mos të hartohet diçka vetëm sa për sy e faqe, ndaj sivjet MB do të kryejë obligimet, përveç këtyre dy ligjeve edhe 7 të tjera, duke filluar qysh në këtë muaj dhe në mars. Pasi që përfundoi paraqitjen e parë të planeve të sivjetme të MB, anëtarët e Komisionit parashtruan pyetje dhe sugjerime.

**Adem Salihaj** filloi me parashtrimin e kritikave për dy vjet të kaluara ngase për shkak të mos punës së ministrisë edhe ky Komision nuk ka përmbush planet as 10%, gjithashtu kërkoi sqarime për mos angazhim të ministrisë sa i përket punës monitoruese të komisionit lidhur me ligjin për inspektorate, rikthimin e inspektorëve në nivelin qendror sa i përket pyjeve etj., mos reagimi i ministrisë sa i përket importit të bimëve dhe fidanëve (aktuale ajo e mjedrave), importi pa kontroll i vajit të palmës etj.

**Salih Salihu** konstatoi se Qeveria (MB) vetëm ka bartur punët e vitit 2016 në këtë vit dhe nuk mjaftojnë arsyetimet e ministrit për mos punën e Qeverisë dhe lënien anash të mirëqenies së qytetarëve, sidomos kjo vlen për mungesën e strategjisë së bujqësisë, kurse për grurin tha se me 13 centë të çmimit fermeri ynë as që mund të mendojë përballimin e kësaj kur dihet se fermerët e rajonit dukshëm dallohen nga ky i Kosovës pa kurrfarë kushtesh që i ndihmojnë, vaji palmës importohet 1.8 milion kg në vit pa asnjë kontroll, qumështi nga vendet e tjera, pjekurinë etj. të gjitha këto me buxhet të varfër, parat e mërgimtarëve tanë nuk menaxhohen në aspektin zhvillimor etj.

**Time Kadrijaj** iu bashkëngjiti diskutimeve me konstatimin se Ministria e Bujqësisë nuk është e vetmja që nuk realizon planin ndaj kërkoi sqarimin sa mund MB sivjet të realizojë atë që ka propozuar në plan dhe çka është prioritet.

**Duda Balje** u përqendrua në ndihmat për fermerët sa realizohen dhe mundësitë për adaptimin me kriteret e miratuara në MB, dëmet sidomos për kafshët e ngordhura, koha e ftohtë etj., ndaj zyra që ndihmon sa ka buxhet për ndihma.

**Ministri** theksoi se i kupton kritikën dhe shqetësimet që janë edhe të drejta, por potencoi se mundësitë nuk lejojnë tejkallimet ligjore, p.sh. importi nuk është në kompetencën e MB, alarmimi duhet të saktësohet edhe pse MB ka përgjegjësinë e politikëbërjes.

**Adem Salihaj** ishte i mendimit se komunat nuk kërkojnë kthimin e nivelit qendror për pyje, ministri tha të kundërtën ngase nuk kanë roje, dhe tha se niveli qendror është më efikase për shkak se do të mbrojnë pasurinë kombëtare më mirë, për material e fidanëve MB do të angazhohet për trajtim legal, kurse sa i përket importit MB merr parasysh analizat e IKB, ngase p.sh. vaji palmës nuk ka ndalesë nga BE për atë edhe tregtohet, AUV ka qenë gabim futja e tij në ombrellën e zyrës së kryeministrit ngase më mirë do të kontrollohet ushqimi nga MB, ashtu si është në shumicën e vendeve evropiane, për strategjinë e bujqësisë tha se është ndërprerë më 2013 për shkak të zgjedhjeve të parakohshme, kurse vazhdimi i hartimit kërkon punë shtesë ngase duhet të hiqen të vjetrat, kritikata rreth grurit duhet të trajtohen në aspektin e sipërfaqeve të mbjellë dhe ajo vazhdimisht po përmirësohet, por me një rritje të përgjegjësisë dhe kontrollit të cilësisë së mbjelljeve, në përgjithësi shikuar, ai konstatoi se bujqësia asnjëherë nuk ka qëndruar më mirë në aspektin e krahasimit para 30 vjetëve apo 20, për konstatimin e ekzistimit të kompanive kundërligjore ftoi Komisionin në luftimin e përbashkët duke i denoncuar ato. Në fund shtoi se plani i paraparë do të përmbushet nga MB dhe do të kryejnë atë çka i takon kësaj ministrie dhe përgjegjësisë që ju takon duke sqaruar edhe më detalesh për disa degë në ministri. Edhe një herë potencoi se programet në MB janë konkurruese dhe do të aplikohet kriteri i barazisë duke pasur parasysh edhe ata që kanë aplikuar për 2 ha ose 50 ari, ngase në Kosovë është aktuale fragmentimi i tokave, ndërsa kompensimet për dëme gjithashtu janë aplikuar, por ato nuk obligojnë ministrinë ngase nuk janë të parapara në ligj, ndaj ato raste duhet të saktësohen me një draft duke rregulluar procedurat përkatëse dhe fondet të cilat zakonisht janë të limituara me një metodologji të saktë për vlerësimin e dëmit.

**Salih Salihu** reagoi: “Ju, ministër, përkundër faktit që nuk hartoni legjislacionin dhe arsyetoni këtë dobësi, nuk tregoni asgjë për dështime, pra ju jeni qeveri, ju keni përgjegjësi, ju duhet të keni koordinim ndërministror, kurse në praktikë kemi vetëm jo koordinimet dhe ekonomi të tregut, ku gjithçka blihet nga jashtë dhe lihet e tëra në mëshirën e tregut, ndërsa ju monitoroni këtë gjendje të pashpresë”, potencoi çështjen e grurit. Ministri u përgjigj se çështja e grurit nga shteti në shtet ndryshon sa i përket prodhimit edhe pse buxhetet e atyre shteteve ndryshojnë nga njëra-tjetra, gjithashtu në vazhdim tregoi për veprimet e ministrisë në disa fusha tjera, siç janë akuakultura, tregun e lirë etj. dhe potencoi faktin se përgjegjësia nuk i ik.

**Emilija Redzeqi** potencoi se pas vitit 2011 ka menduar të bëjë presion në qeveri sa i përket realizimit të drejtave të pakicave në fushën e bujqësisë, por tani ajo shprehu falënderim publik ministrit në emër të pakicës boshnjake për dhënien e mundësisë fermerëve të rinj nga minoritetet, sidomos në konkurrencë dhe për lehtësime në zhvillimin rural, ndërsa shfrytëzoi rastin për një kritikë sa i përket inspektoratit sidomos atë fitosanitar i cili fare nuk ekziston në shumë komuna.

**Adem Salihaj** vazhdoi me kritika për mos punën e ministrisë, sidomos rreth importit i cili nëse bëhet pa nevojë ajo vetëm dëmton, nuk ka punë dhe refleksion të përbashkët qeveria, për kafshë nuk ka taksë doganore dhe kemi mjaft pasoja të dëmshme, pa marrë parasysh që ministri arsyetohet pasojat reflektojnë dëmshëm (ceku rastin e mjedrave të sëmura ngase ato jo se vetëm janë të sëmura, por kanë shkaktuar dëme të shumfishta në tokën e mbjellë ku tani 7 vjet nuk do të prodhojnë asgjë për shkak se është dëmtuar nga ato fidanë, sa i përket menaxhimit të pyjeve potencoi se Komisioni në terren nuk ka dëgjuar ankesa për menaxhim komunal apo kthimin e menaxhimit qendror, fundja siç tha

ai “edhe po të kthehet menaxhimi qendror duhet të bëhet vetëm arritja e qëllimit të mbrojtjes së pyjeve” dhe mbrojta nuk mund të kryhet vetëm me dy inspektorë. Sa i përket pakicave ai ndërhyri sepse vetëm ato nuk jetojnë në viset malore ku jetojnë edhe pjesëtarët e shumicës shqiptare, pra nuk kemi të bëjmë me ndonjë lloj diskriminimi, por mundësinë e MB për të ndihmuar banorët në viset më të larta.

**Salih Salihu** pyeti për përfshirjen e AUV në MB dhe a do të ketë sukses kjo, gjithashtu paralajmëroi MB se Komisioni ka marrë iniciativë për hartimin e planit për cilësinë e bukës.

**Murat Hoxha** u interesua për mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet dhe sa po arrin ministria t’i mbrojë ngase tërë Kosova është shndërruar në një katund të madh, gjithashtu pyeti për realizimin e komasacionit.

**Ministri** mbështeti ndërhyrjen e Adem Salihajt për pakica ngase në përgjithësi ministria duhet të ndihmojë banorëve në viset malore edhe pse pakicat deri tani kanë pasur vështirësi për shkak se kanë aplikuar për sipërfaqe më të vogla dhe mundësi më të vogla për ndihma, ndaj kjo tani e tutje do të eliminohet, kurse për kthimin e kompetencave menaxheriale qendrore tha se është kërkesa e BE- së në mënyrë që të zbatohen standardet e ACQUIS, kthimi i AUV në MB nuk zgjedh ndoshta krejt problemet, por lehtësohet kontrolli ndaj kësaj agjencie, siç është edhe në shumicën e vendeve evropiane. Kjo agjenci nën mbikëqyrjen e MB, për shkak se tokat bujqësore MB i ka klasifikua në 4 klasa, ato ashtu edhe do të mbrohen edhe më tutje duke dhënë pëlqimet vetëm aty ku mund të jepet në shfrytëzim nga komuna përkatëse sipas Ligjit për tokat bujqësore dhe nëse nuk ka komasacion apo ujitje, edhe pse disa komuna fare nuk njoftojnë për këto leje sipas planeve që miratohen në kuvendet përkatëse komunale, lidhur me pyetjen për komasacion ministri potencoi se duhet të riaktivizohet komasacioni nga vitet 80- ta ngase atëherë kanë përfunduar regjistrat, por nuk janë regjistruar në kadastër, për iniciativën e komisionit për të hartuar ligjin për cilësinë e bukës ndërhyrje kishte edhe Adem Salihaj i cili tha se po që se parashihet diçka për këtë në ligjin për ushqimin, ndoshta Komisioni nuk do të ketë nevojë për këtë hartim ose me një amendament do të shqyrtojë këtë mundësi të ndërhyrjes, po ashtu për monitorimin e ligjit për ushqimin bashkërisht me ministrin u konstatua nëse hartohet deri në mars, ndoshta nuk do të ketë nevojë Komisioni të monitorojë fare, përndryshe ministri konfirmoi mbështetjen e ministrit nëse komisioni do të hartoi këtë ligj.

**Shqip Muja** theksoi se projektligji i cili do të vijë për AUV do të analizohet nga Komisioni, por MB duhet të sugjeroi cilat divizione nuk funksionojnë ashtu si duhet, megjithatë ai ishte i mendimit se AUV duhet të raportojë te kryeministri. Në fund **kryetarja** falënderoi ministrin dhe konstatoi se së shpejti Komisioni prapë do të takohet me ministrin rreth raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2016 për të cilin raport ajo kërkoi fillimisht të dërgohet me shkrim deri në mars, kurse shqyrtimi të bëhet nga Komisioni në muajin prill.

#### 4. Të ndryshme

Kryetarja në këtë pikë ftoi komisionin të shqyrtohen dy rekomandime, ndaj u vendos:

- Të dërgohet në leximin e dytë projektligji për mbrojtjen nga zhurma, dhe
- Të dërgohet në leximin e parë projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,

- Për propozim- hartimin e ligjit për Memorialin Ibrahim Rugova, Komisioni do të diskutojë në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 13.00.

**E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit**

Kryetarja e Komisionit,

-----

**Duda Balje**